

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe mr.sc Muhamet Rexha, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses L.G, nga Lipjani, të cilën e përfaqëson me autorizim N.G, nga Lipjani, kundër të paditurës KS ''S'', me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim F.M, lidhur me shpërblimin e dëmit material dhe jo material, përkitazi me revizionin e paditëses dhe atë të së paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.570/2013, datë 21.10.2015, në seancën e mbajtur më 22.2.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I PJESËRISHT pranohet revizioni i paditëses dhe ndryshohen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.570/2013, datë 21.10.2015, dhe ai i Gjykatës Komunale në Lipjan, C.nr.59/2011, datë 30.11.2012, për aq sa kanë të bëjnë me shpërblimin e dëmit jomaterial, ashtu që, në emër të dhimbjeve shpirtërore për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, gjykohet shuma prej 5.400 €; në emër të dëmit material për ushqim të përforcuar, gjykohet shuma prej 126 € dhe për kujdesin e personit të tretë gjykohet shuma prej 210 €, me kamatën që paguajnë bankat për mjetet e depozituara mbi një viti, pa destinim të caktuar, dhe kjo nga data 30.11.2012 gjer te pagesa definitive, ndërsa obligohet e paditura që, në emër të shpenzime procedurale, të paguajë shumën prej 851,04 € .

II Pjesërisht pranohet revizioni i të paditurës dhe ndryshohen aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta për sa u përket shpenzimeve të rehabilitimit, ndërsa lidhur me këtë pjesë refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses për shumën prej 240 €..

II. Pjesët e tjera të revizionit të paditësit dhe atij të të paditurës refuzohen si të pabazuara.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Komunale Lipjan, C.nr.59/2011, datë 30.11.2012, është aprovuar kërkesëpadia e paditëses dhe është detyruar e paditura që paditëses L.G., në emër të shpërblimit të dëmit material dhe jo material, t'ia paguajë sumat:

- në emër të dhimbjeve fizike, shumën prej 3500 € ,
- në emër të frikës së përjetuar, shumën prej 3.000 €,
- në emër të shëmtimit trupor, shumën prej 1000 €,
- në emër të dhimbjeve shpirtërore për zvogëlim të aktiviteti të përgjithshëm jetësor, shumën prej 3.600 €, ndërsa
- në emër të dëmit material, për rehabilitim, shumën prej 243 €.

Kërkesëpadia e paditëses për ushqim të përforcuar në shumën prej 126 € dhe për kujdesin e personit të tretë për paditësen në shumën prej 210 €, është refuzuar. Është obliguar e paditura që të gjitha këto shuma t'i paguajë me kamatën që paguajnë bankat për mjetet e depozituara mbi një vit, pa destinim të caktuar, llogaritur nga data 20.11.2012, gjer në pagesën definitive si dhe t'ia paguajë paditësit, në emër të shpenzimeve procedurale, shumën prej 851,04 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, me kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.570/13, datë 21.10.2015, është pranuar pjesërisht ankesa e të paditurës dhe është ndryshuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përkitazi për dëmin jo material, ashtu që për dhimbje fizike janë gjykuar shumat si në dispozitiv të aktgjykimit të goditur, llogaritur nga data 8.10.2012 (ditë e marrjes së mendimit të ekspertëve), deri në pagesën definitive.

Me të njëjtin aktgjykim është refuzuar ankesa e paditëses që ka të bëjë me pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë, i cili është ndryshuar sa u përket shpenzimeve procedurale, duke u gjykuar shuma prej 500 €.

Kundër aktgjykimit në fjalë, në afatin ligjor paditësja ka ushtruar revizion, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë revizionin dhe ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë ose të dyja aktgjykimet t'i prishë dhe lëndën t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Kundër aktgjykimit në fjalë, në afatin ligjor ka ushtruar revizion edhe e paditura, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitivave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë revizionin, të dyja aktgjykimet t'i prishë dhe lëndën t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Në përgjigje të revizionit të së paditurës, paditësja ka propozuar që ai të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur dhe shkresave të lëndës në pajtim me nenin 215 të LPK, konstatoi:

Revizioni i paditëses dhe ai i së paditurës, janë pjesërisht të bazuara.

Në procedurë të zhvilluar që i ka paraprirë marrjes së aktgjykimit të goditur, në bazë të provave të administruara dhe vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 8 të LPK, është vërtetuar fakti se më 1.12.2009 kishte ndodhur një aksident trafiku në magjistralen Prishtinë-Ferizaj, tek udhëkryqi i Janjevës, kur automjeti i markës "...", me targa ..., është përplasur mbi automjetin "...", me targa K.S, në të cilin paditësja ishte bashkudhëtare; automjeti me të cilin ishte shkaktuar aksidenti kishte qenë i siguruar tek e paditura për dëmin e shkaktuar personave të tretë. Drejtuesi i automjetit "...", për shkaktimin e këtij aksidenti, është shpallur fajtor me aktgjykimin e Gjykatës Komunale Lipjan, P.nr.213/2010 dhe i është shqiptuar një dënim me kusht. Në këtë aksident të komunikacionit paditësja ka pësuar dëm jo material dhe dëm material. Sipas raportit të ekspertëve mjekësorë, paditësja ka pësuar lëndime të rënda trupore. Sipas mendimit të ekspertit Dr. A.F., ortoped traumatolog dhe N.H., psikologe, paditësja L. ka

pësuar dhimbje të intensitetit posaçërisht të rëndë, që ka zgjatur 1 orë, dhimbje të intensitetit të rëndë - 1 ditë, dhimbje të intensitetit të mesëm - 10 ditë dhe dhimbje të intensitetit të ulët - 21 ditë; frikë primare - disa sekonda, frikë - sekondare të intensitetit të lartë - 2 orë, frikë sekondare të intensitetit mesatar - 3 orë; zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën 18 % ; shëmtimi trupor në shkallë të ulët; ndihma e huaj ka qenë e nevojshme 3 javë, ushqimi i përforcuar 3 javë, kurse rehabilitimi në vitin e parë ka qenë i nevojshëm 15 ditë.

Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar, ashtu që ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën ankimore, ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar pjesërisht ankesën e të paditurës përkitazi me dhimbjet fizike, frikën e pësuar dhe zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, ashtu që pjesën tjetër të ankesës së paditëses e ka refuzuar si të pabazuar dhe aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, shumat e gjykuara nga ana e gjykatës së instancës më të ulët, që kanë të bëjnë me shpërblimin e dëmit jomaterial, me zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, nuk janë adekuate dhe në përputhje me natyrën e shpërblimit të dëmit jomaterial, duke marrë parasysh rëndësinë e shkallës së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, siç parashikohet nga neni 200 par.1 dhe 2 të Ligjit të Detyrimeve. Kjo Gjykatë, duke pranuar pjesërisht revizionin e paditëses, e ndryshoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ashtu që, në emër të dëmit jo material, paditëses L., ia caktoi shumën prej 5.400 €. Nisur nga kjo gjendje, duke pasur parasysh moshën e paditëses në kohën kur ka pësuar aksidentin, natyrën e lëndimeve si dhe qëllimin e shpërblimit të dëmit jomaterial, kjo Gjykatë konsideron se, shumat e caktuara, mund të përjetohet nga paditësja si një satisfaksion i konsiderueshëm për dhimbje shpirtërore të pësuar për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor. Njëherësh, duke marrë parasysh edhe standardin jetësor të qytetarëve në Kosovë, por edhe praktikën e deritanishme të gjykatave tona, shumat e caktuara të shpërblimit të dëmit jomaterial për paditësen, në emër të dhimbjeve fizike dhe frikës së pësuar, nga ana e gjykatës së shkallës së dytë, në pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të saj, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, janë reale dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

Gjykata Supreme e Kosovës i vlerëson si të bazuara thëniet e revizionit të paditëses se asaj i takon shpërblimi i dëmit material për ushqim të përforcuar dhe kujdes nga një person i tretë, për arsye se ajo, sipas raportit të ekspertit mjekësor, për shkak të lëndimeve të pësuar në aksidentin e komunikacionit, ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar dhe për kujdesin e ofruar nga një person i tretë në kohëzgjatje prej 3 javësh, të cilat shumat të caktuara nga kjo gjykatë konsiderohen reale dhe në harmoni me praktikën gjyqësore .

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se vendimi për kamatën e aprovuar mbi shumën e dëmit jomaterial nga dita e dhënies së mendimit të ekspertëve, është i papranueshëm. Kamatëvonesa për shpërblimin e drejtë në të holla të dëmit jo material fillon të ecë nga dita e dhënies së aktgjykimit të shkallës së parë, me të cilin është caktuar shpërblimi. Me rastin e vendosjes për shumën e shpërblimit të drejtë në të holla, gjykata duhet ta ketë parasysh edhe kohën që ka kaluar nga shkaktimi i dëmit deri te marrja e vendimit, nëse kohëzgjatja e pritjes së

satisfaksionit dhe rrethanat e tjera të rastit justifikojnë një gjë të tillë. Sipas Ligjit për Detyrimet dhe ndryshimeve të nenit 277 të LMD (“Fletorja zyrtare e RSFJ” nr. 39/85) kamatëvonesa ligjore paguhet sipas normës që paguajnë bankat për mjetet e depozituara mbi një viti, pa destinim të caktuar.

Janë të papranueshme thëniet e ngritura në revizionin e të paditurës se ekspertizat e ekspertit të ortopedisë dhe atij të neuropsikiatrisë nuk janë bindëse, për arsye se ekspertët raportin e tyre e kanë mbështetur mbi dokumentacionin që gjenden në shkresat e lëndës, ndërkaq përmes revizionit nuk mund të pretendohet vërtetimi jo të plotë dhe i gabuar i gjendjes faktike.

Gjykata Supreme lidhur me shpenzimet procedurale vendosi që ato në tërësi t’i a ngarkojë të paditurës në kuptim të nenit 453.3 të LPK, sepse lidhur me pjesën refuzuese nuk ka pasur shpenzime të veçanta.

Për arsyet e dhëna më lart dhe me zbatimin e nenit 224.1, u vendos si nën pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, kurse me zbatimin e nenit 222 të LPK u vendos si në pikën III të dispozitivit .

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
Rev.nr.39/2016 më 22.2.2016

Kryetari i kolegjit,
Erdogan Haxhibeqiri